



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 771/5 Prot.

Vlorë më, 19.03 2026

VENDIM

Nr. 08, datë 19.03.2026

PËR
PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË "GAZETËS UNIVERSITARE UNIVLORA"
DHE STRUKTURËS SË "RADIOS STUDENTORE UNIVLORA"

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 3, pika 4, nenit 15 dhe nenit 138 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit të Bibliotekës dhe Botimeve datë 18.12.2025, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturave të "Gazetës Universitare UniVlora" dhe "Radio Studentore UniVlora", sipas materialit bashkëlidhur, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Ngarkimin e Sektorit të Bibliotekës dhe Botimeve për për zbatimin e këtij vendimi .
3. Ngarkimin e njësive përkatëse akademike dhe administrative për mbështetjen e funksionimit të këtyre strukturave.
4. Ky vendim i njoftohet Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike për realizimin e njoftimeve dhe publikimin e tij në faqen zyrtare Web të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ





Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 18.12.2025

Lënda: Propozim per strukturen Gazeta Universitare Univlora

Propozim per strukturen e Radio Studentore Univlora

Rektores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë
Prof. Dr. Aurela SALIAJ**Strukture Radio Studentore Univlora****Rubrikat javore****1. Mëngjesi Studentor**

Lajmet më të rëndësishme universiteti, njoftime për aktivitete të ditës, kujdes për shëndetin mendor dhe motivim për ditën që fillon. Mund të përfshihen citate frymëzuese dhe pyetje interaktive për dëgjuesit, që të krijohet një energji pozitive. 15–20 minuta

Numri i studentëve: 2–3 (1 kryesor + 1–2 bashkëmoderues)

Formati: Lajme + citate + pyetje për dëgjuesit + një këshillë praktike për ditën

2. Biblioteka Studentore

Përmbajtja: Lexim i librave të ndryshëm nga ese filozofike, tregime, poezi, deri tek pjesë nga literatura bashkëkohore. Pas leximit, diskutohet për temat, mesazhet dhe lidhjet me jetën studentore. Mund të sugjerohen libra të rinj dhe të hapet rubrika e pyetjeve nga dëgjuesit për interpretim. Struktura: 20–30 minuta Numri i studentëve: 1 leximtar kryesor + 1 komentues

Formati: Lexim + analizë e shkurtër + rekomandime librash + diskutim interaktiv

3. Mikrofoni Studentor

Përmbajtja: Intervista me studentë, pedagogë dhe alumni. Fokus në rrëfime personale, sfida gjatë studimeve, projekte të veçanta ose eksperiencë frymëzuese. Qëllimi është që të transmetohet motivim dhe të krijohet lidhje mes studentëve dhe komunitetit akademik.

Struktura: 20–25 minuta. Numri i studentëve: 1 moderator + 1 intervistues

Formati: Pyetje -përgjigje + histori motivuese + reflektime personale

4. Këndi i Karrierës Studentore

Përmbajtja: Informacion mbi bursa, Erasmus+, praktikë pune, këshilla për shkrimin e CV-ve, përgatitje për intervista dhe aftësi profesionale. Mund të ftohen ekspertë, alumni ose pedagogë që japin këshilla praktike. Struktura: 15–20 minuta

Numri i studentëve: 1 moderator + 1 ekspert i ftuar

Formati: Informativ + pyetje nga dëgjuesit + shembuj praktikë



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I BIBLIOTEKËS DHE BOTIMEVE

5. Sporti dhe aktivitetet Studentore

Përmbajtja: Lajme sportive nga kampusi, rezultate garash, sfida midis studentëve dhe aktivitete për shëndetin fizik. Mund të përfshihen intervista me sportistë studentë dhe këshilla për stërvitje të lehtë gjatë ditës. Struktura: 15 minuta Numri i studentëve: 1–2 moderatorë
Formati: Koment + intervista + tips për aktivitet fizik dhe mirëqenie

6. Erasmus+ Studentor

Përmbajtja: Përvoja dhe sfidat e studentëve që kanë marrë pjesë në programe ndërkombëtare, këshilla për aplikim, ndarja e kulturave të ndryshme dhe sugjerime për studentët që duan të aplikojnë. Struktura: 15–20 minuta Numri i studentëve: 1 moderator + 1 student me eksperiencë
Formati: Rrefim personal + pyetje dhe përgjigje + këshilla praktike

7. Dritare Studentore

Përmbajtja: Rreth kulturës dhe traditave të vendeve të tjera, udhëtime, përvoja studentore jashtë vendit dhe intervista me studentë që kanë eksploruar botën. Fokus në njohje të botës dhe integrim kulturor. Struktura: 20 minuta Numri i studentëve: 1–2 moderatorë
Formati: Intervista + përshkrim i vendit + këshilla për studentët

8. Këndi i Mendjes së Shëndoshë

Përmbajtja: Shëndeti mendor dhe emocional, motivim, teknika relaksimi, balanca mes studimeve dhe jetës personale. Mund të ftohet psikolog ose mentor për të dhënë këshilla praktike. Struktura: 15 minuta Numri i studentëve: 1 moderator + 1 ekspert
Formati: Tipse të shkurtra + pyetje nga dëgjuesit + ushtrime praktike

9. Zëri i Auditorit Studentor

Përmbajtja: Opinione, debate dhe diskutime mbi temat që prekin studentët. Përfshihen pyetje publike, anketime dhe debate konstruktive. Struktura: 20 minuta .
Numri i studentëve: 2 moderatorë + 1–2 studentë për debat
Formati: Mini-debat + pyetje publike + reflektime

10. Shije - Ushqim

Përmbajtja: Receta të shpejta dhe të shëndetshme, ushqim ekonomik për studentët, rekomandime vendesh për të ngrënë dhe intervista me kuzhinierë ose studentë që kanë eksperiencë në kuzhinë. Struktura: 15 minuta Numri i studentëve: 1–2 moderatorë
Formati: Përgatitje live + këshilla praktike + intervista

11. Tryeza e Diskutimit Studentor

Përmbajtja: Debate mbi çështje sociale, mjedisore, arsimore, kulturore, akademike dhe temat që ndikojnë jetën studentore. Diskutime strukturore me pyetje nga dëgjuesit.
Struktura: 25–30 minuta . Numri i studentëve: 1 moderator kryesor + 3–4 pjesëmarrës
Formati: Debate + pyetje dhe reflektime

12. Historia e Kampusit Studentor

Përmbajtja: Kujtime, rrëfime dhe ngjarje nga historia e universitetit. Përfshihen intervista me alumni, arkiv audio dhe storytelling. Struktura: 15–20 minuta
Numri i studentëve: 1 moderator + 1–2 studentë

13. Profili i Javës

Përmbajtja: Zëra inspirues nga pedagogë, alumni ose studentë që kanë arritur diçka të veçantë. Fokus në motivim dhe shembuj frymëzues. Struktura: 20 minuta
Numri i studentëve: 1 moderator + 1 student intervistues
Formati: Intervista + reflektim

14. Publicistikë studentore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI I BIBLIOTEKËS DHE BOTIMEVE

Përmbajtja: Poezi, ese, shkrime dhe krijimtari studentore. Diskutime mbi ide, interpretime dhe frymëzim për krijimtarinë. Struktura: 15 minuta Numri i studentëve: 1–2 moderatorë
Format: Lexim + analizë + rekomandime krijuese

15. Motiv studentor

Përmbajtja: citate motivuese të njerëzve të shquar. Ligjërime të njerëzve të shquar mbi artin e të folurit bukur. Struktura: 10–15 minuta . Numri i studentëve: 1 moderator + 1 ekspert
Format: Përmbledhje + citate motivuese + njoftime

16. Dita e Fakultetit të Shëndetit

Përmbajtja: Lajme, projekte, këshilla shëndetësore dhe aktivitetet e studentëve të Fakultetit të Shëndetit. Struktura: 20 minuta. Numri i studentëve: 1 moderator + 1–2 studentë
Format: Intervista + tips shëndetësore + projekte studentore

17. Dita e Fakultetit të Shkencave Teknike

Përmbajtja: Projekte, sfida dhe inovacione nga studentët teknikë. Diskutim mbi zhvillime teknologjike dhe praktika profesionale. Struktura: 20 minuta Numri i studentëve: 1 moderator + 1–2 studentë

Format: Intervista + këshilla praktike + projekte

18. Dita e Fakultetit të Ekonomisë

Përmbajtja: Analiza ekonomike, praktika, bursat dhe aktivitetet e studentëve të Ekonomisë. Struktura: 20 minuta . Numri i studentëve: 1 moderator + eksperte
Format: Intervista + diskutime

19. Dita e Fakultetit të Shkencave Humane

Përmbajtja: Projekte kulturore, aktivitete humanitare dhe rrëfime të veçanta nga studentët e Shkencave Humane. Struktura: 20 minuta . Numri i studentëve: 1 moderator + 1–2 studentë
Format: intervista + promovim aktiviteteve

20. Këshillimi i Karrierës Studentore

Rubrika fokusohet tek ndihma për studentët në zhvillimin profesional dhe orientimin drejt karrierës. Përfshihen këshilla praktike për hartimin e CV-së, përgatitjen për intervista, identifikimin e bursave dhe praktikave profesionale, si dhe trajtimi i aftësive të buta si komunikimi, menaxhimi i kohës dhe punë në ekip. Mund të ftohen pedagogë, alumni ose ekspertë të karrierës për intervista dhe sesione këshillimi.

Struktura: 20 minuta. Numri i studentëve: 1 moderator kryesor + 1 ekspert ose student me eksperiencë

Formati: Intervistë me ekspert ose alumni(Pyetje dhe përgjigje nga dëgjuesit

Këshilla praktike për aftësi profesionale

Informacion mbi mundësi bursash, Erasmus+ dhe praktika pune)

Qëllimi: Studentët të ndihen të udhëzuar dhe të motivuar për të marrë vendime të informuara për karrierën e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I BIBLIOTEKËS DHE BOTIMEVE

2. Struktura Gazeta Universitare Univlora

1	Editorial	Një artikull i shkurtër (300–500 fjalë) i shkruar nga redaktori ose një student i përzgjedhur. Koment mbi ngjarjet e fundit në universitet ose në jetën studentore. Reflektim mbi tema si motivimi, vetëdisiplina, shëndeti mendor, kulturë, inovacion, arsim Një mesazh frymëzues ose sfidues për studentët.etj
2	Zëri i studentit	Opinione, reflektime, këndvështrime nga studentët.
3	Profili i javës	Intervista me studentë, pedagogë dhe alumni të shquar.
4	Jeta studentore	Evente, aktivitete, organizata dhe nisma që gjallërojnë jetën universitare
5	Keshillim karriere	Bursa, Erasmus+, praktika pune, këshilla studimi dhe udhëzime akademike, Përvoja ndërkombëtare, shkëmbime kulturore dhe tregime nga studentët jashtë vendit.
6	Biblioteke	Rekomandime librash, filmash, ekspozita dhe krijimtari studentore, Ese filozofike, poezi dhe shkrime krijuese.
7	Zërat kritikë	Analiza, problematika, debat dhe kritika konstruktive.
8	Arkiva historike universitare	Trëfime nga fillimet e universitetit, themelimi, evolucioni i fakulteteve, momentet kryesore. Kujtime dhe histori nga ish-studentë dhe pedagogë të njohur. Fotografite, dokumentet historike të arkivuara.Ngjarje kulturore, sportive dhe akademike që kanë shënuar universitetin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Specialist Përgjegjës i Laboratorit Mediatik UV

Marjeta MËRKURI